

E MAJTA NË KOSOVË

Pse duhet të bëhet profilizimi i partive politike; Domosdoshmëria e organizimit të së majtës.

Sot, pjesa më e madhe e politikës është shumë keq. Politika çalon. Ajo po e pengon procesin e mirëqenies së qytetarëve të vendit me gjymëtsinë e saj, pasi në vete ka shumë sëmurje të së kaluarës si janë: mentaliteti se në politikë nuk duhet te ketë moral por gënjeje masën, elektoratin merrja votën dhe puno për gjepin tënd; elimino të aftët në politikë ose shfrytëzoi ata kur i ke diskriminuar!; bëri biznes idealet aktuale të masës si në çështjen kombëtare ashtu edhe në atë qytetare!; thirru në standarde evropiane dhe universale e shfrytëzo politikën e Serbisë në raportet e brendshme kosovare, si me popullin tënd ashtu edhe me komunitetet tjera; pa asnjë dhimbje mos i lë të gjallojnë talentët dhe të moralshmit në politikë, sepse -ata janë rreziku i shoqërisë dhe kombit! etj.

Pa u rregulluar politika nuk rregullohen dot as institucionet e Republikës së Kosovës. Pa brum të mirë dhe të shëndetshëm nuk bëhen bukët e mira që e mbajnë jetën dhe shëndetin për qytetarët e një vendi. Thjeshtë, pa tulla të pjekura, apo pa material ndërtimor të sprovuar cilësisht, nuk mund të ndërtohet godina e cilësore dhe vërtetë e qëndrueshme. Dhe, për ta bërë cilësore, për ta rregulluar e shëndoshur politikën, në rend të parë, tani, në Republikën e Kosovës duhet: **Profilizimin i partive politike**, dhe ai për këto arsye:

1. profilizimi i partive politike qet në shesh qëllimet konkrete të partive politike dhe zvogëlon mundësinë e mashtrimit të votuesve;
2. tipizimi i partive politike në të majta apo të djathta si dhe funksionimi i tyre si të tilla është një hap përpara që duhet të ndodhë në politikë në Kosovë;
3. profilizimi politik rritë përgjegjësinë politike si te udhëheqjet politike ashtu edhe tek trupi zgjedhor;
4. profilizimi i partive politike stabilizon elektoratin partiak apo trupin zgjedhor në tërësi;
5. ndikon në rritjen e vetëdijes politike për rëndësinë dhe peshën shoqërore, shtetërore, kushtetuese e kombëtare të votës, duke pakësuar mundësitë e manipulimit dhe të tregtisë me votë;
6. e tejkalon gjuhën " kosovare" të parapolitikës së paprofilizuar dhe organizon idenë e gjuhës shqipe në politikë e cila bënë funksionale nocionet politike të së majtës dhe të djathtës në Kosovë me çka mund të kuptohemi dhe të komunikojmë normalisht e lirshëm me qarqet politike në Evropë dhe botë.

Kam mendimin dhe bindjen se **organizimit të së majtës së mirëfilltë dhe moderne ka potencial të madh dhe mund të ndikojë shumë në profilizimin e njëmendët të partive politike në Republikën e Kosovës.**

Jo vetëm kjo pikë, por, edhe pika tjera që shkojnë në favor të rregullimit të politikës, e bëjnë **domosdoshmërinë e organizimin e të majtës në Republikën e Kosovës.** Ja disa nga këto ide që po më sillen në mend tani:

1. Organizimi i së majtës në Kosovë ndikon shumë në profilizimin e partive politike;
2. Koha dhe vet mjerimi politik që ekziston tani për tani në Kosovë vërteton katërcipërisht, se tani i ka ardhur koha e daljes në skenën politike i një të majte moderne në Kosovë, vendi i së cilës është i pazëvendësueshëm;
3. e majta në Kosovë duhet të sjellë politikën me standarde evropiane dhe botërore dhe të nxjerr vendin nga kallpet politike të së kaluarës dhe mbeturinat politike të ish-pushtuesve;
4. e majta në Kosovë duhet të kthej shpresën e humbur të qytetarëve të për shtet kushtetues dhe për dinjitet të Republikës së Kosovës;
5. e majta në Kosovë do të duhej të instalojë një politikë ndryshe nga kjo që na ka zhgënjyer dhe ta shpëtoj Kosovën nga anarkia dhe vetëgjyqësia edhe më e madhe se kjo që është, ngase nëse vazhdohet politika aktuale në Kosovë, atëherë zor se do të shpëtojmë nga një luftë civile krejt e padëshirueshme në Kosovë;
6. e majta në Kosovë ka gjasa që me të vërtetë t'u jep një perspektivë e alternativë shpëtimtare qytetarëve të Kosovës ngase në këtë veprimtari politike-kombëtare ka traditë dhe trashëgon vlera të pakontestueshme;
7. Asnjë lloj politike tjetër pos së majtës në Kosovë nuk ka më shumë gjasa që Kosovën ta bëjë shtet social, ngjashëm me synimet e së majtës evropiane për Evropën, prandaj edhe e majta në Kosovë ka mundësi të madhe të veprojë **si një forcë për ndryshime vërtetë pozitive**, kur ish-luftëtarët dhe populli po vuajnë urie.

Prandaj, është e domosdoshme që të gjithë ata që e ndiejmë veten të majtë punojmë pa reshtur që e majta në Kosovë të organizohet dhe të bëhet në Kosovë një forcë e re rregulluese dhe shpëtuese.

Për fund: Shpirti rilindës i popullit dhe qytetarëve të Kosovës ekziston tani e këtu. Populli, ka ditur dhe do të dijë si t'i çmojë vlerat edhe në fushën të cilën më së shumti ia kanë mjegulluar, politikën.

Populli, ka intuitën e vet edhe sot, ku për interesa të veta po mundohen të ia humbin rrugën në oborr. Politikën e bënë ai grup politik që do t'i besoj populli dhe që do të mund ta organizojë masën e zhgënjyer.

Na duhet politikë që orienton, politikë me perspektivë dhe që planifikon edhe për më shumë se 50 vjet, që nuk është kundërhistorike apo kundër së ardhmes sonë.

Politika e së majtës në Kosovë, mund ta rikthej shpirtin në politikën e Republikës së Kosovës. Këtë shpirt të madh shqiptar, ndoshta ende mund ta ruajnë të majtët e vërtetë që nuk janë korruptuar në Kosovë. Atyre iu ka hije që në Republikën e re ta zhveshin politikën nga përmbajtja e vjetër nën petkun e ri "shtetëror".

E majta, nisma e LPK-se dhe e të tjerëve në Kosovë, duhet ta kthej shpirtin shqiptar në skenën politike. Shpirti shtypës ka mbetur në Kosovë dhe ende i ka eliminuar nga skena politike mu vet bartësit më të devotshëm dhe të pakorruptuar të Republikës së Kosovës.

Mitrovicë, prill 2009